

Shtojca 2

Programi paraprak i aktiviteteve për t'u përdorur gjatë përgatitjes së aplikimeve

Seminare për shkrimin administrativ dhe terminologjinë si dhe kurset e kulturës administrative për t'u përgatitur për praktikën e punës

Objektivi i këtyre sesioneve trajnuese, të hartuara në bazë të rezultateve të dala nga vlerësimi i nevojave të trajnimit, është që të ndihmojë nëpunësit civilë të përzgjedhur që të përgatiten për përfshirjen e tyre në një administratë publike në vendet e Bashkimit Evropian. Përvetësimi i njohurive mbi sistemet politiko-administrative, organizimin e tyre, terminologjitë model dhe teknikat e shkrimit të përdorura në administratat publike të shteteve anëtare të BE-së do t'i lejojë pjesëmarrësit të identifikojnë praktikën më të mira përkatëse dhe të transferueshme gjatë praktikës së tyre të punës, duke kapërcyer barrierat midis kulturave të ndryshme administrative. Gjithashtu, do të mbahen leksione për komunikimin ndërkulturor për të lehtësuar procesin e përshtatjes së tyre brenda institucioneve pritëse.

“Shkolla online” me mbikëqyrësit e ardhshëm të praktikës së punës dhe me të diplomuarit e fazës pilot (sesione mentorimi, përfshirë një ditë në prezencë)

Përpara praktikës së punës jashtë vendit, pjesëmarrësit do të lidhen virtualisht për 6 javë në një "shkolle online", me mbikëqyrësit dhe instruktorët nga vendi ku do të kryejnë praktikën. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit do të ndahen në grupe pune sipas vendeve.

Pjesëmarrësit do të duhet të punojnë në një mikroprojekt që do të merret nga tema të ndryshme të integritimit në BE, qeverisjes së mirë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Trajnuesit do të lehtësojnë studimet e rasteve, duke i inkurajuar pjesëmarrësit të punojnë në grupe. Nëpërmjet këtyre leksioneve virtuale, takimeve dhe fazave të reflektimit, pjesëmarrësit do të përcaktojnë qëllimet e praktikës së tyre dhe temat me të cilat do të merren dhe do të përmirësojnë të kuptuarit e tyre për institucionet e ndryshme, proceset dhe sfidat për reformat administrative. Pjesëmarrësit do të angazhohen intensivisht me rastet studimore dhe do të reflektojnë deri në çfarë mase shembujt mund të përmirësojnë proceset brenda kuadrit të përpjekjeve të reformës në administratë publike dhe integritimit të synuar në BE.

Këto seanca dhe puna në grup do të zhvillohen online nëpërmjet një platforme digjitale. Puna në grup do të mbështetet profesionalisht dhe pedagogjikisht. Do të organizohen gjithashtu shkëmbime të rregullta virtuale ndërmjet grupeve të projektit dhe personave përkatës të kontaktit në INSP, Universitetit Kehl ose një nga institucionet e tjera partnere të projektit.

Gjithashtu, nëpunësve civilë shqiptarë që kanë marrë pjesë në fazën pilot të programit, do t'u ofrohet të mentorojnë pjesëmarrësit e fazës së re të programit. Shkëmbimi i përvojës së tyre do të jetë një vlerë e shtuar për të udhëhequr grupin e ri të nëpunësve civilë shqiptarë, për të shfrytëzuar sa më shumë pjesëmarrjen e tyre në program dhe për të promovuar kompetencat e tyre të reja të fituara në administratën vendase.

Dy seminare tre ditore mbi (1) përafrimin ligjor dhe koordinimin e negociatave me BE, dhe (2) koordinimin e politikave dhe reformën e administratës publike

Prioriteti i këtyre seminareve trajnuese do të jetë forcimi i kompetencave të nëpunësve civilë shqiptarë në fushat e përafrimit dhe harmonizimit ligjor, koordinimit dhe menaxhimit të negociatave me BE-në, koordinimit të politikave dhe reformës së administratës publike.

Duke pasur parasysh se pjesëmarrësit janë nëpunës civilë që punojnë në administratën publike në Shqipëri, seminarët e trajnimit do të bazohen në qasjen e zhvillimit të kompetencave. Duke i siguruar

pjesëmarrësve aftësi dhe mjete praktike të cilat ata do të jenë në gjendje t'i zbatojnë drejtpërdrejt kur të kthehen në pozicionet e tyre të punës.

Agjenda e trajnimit do të hartohet përmes metodave të integruara të trajnimit që lejojnë sesione që janë të orientuara drejt praktikës dhe shumë ndërvepruese. Çdo temë do të trajtohet përmes:

1. Listës së dokumenteve dhe publikimeve që do të jepen para trajnimit të cilat pjesëmarrësit do të inkurajohen t'i lexojnë para sesioneve.
2. Ligjërata hyrëse që u mundëson pjesëmarrësve të forcojnë dhe përditësojnë njohuritë e tyre në fushën e përmbajtjes.
3. Ushtrim praktik ose simulues që u mundëson pjesëmarrësve të zhvillojnë në mënyrë aktive kompetencat e tyre dhe të ndajnë përvojat e fituara gjatë praktikës.

Dy workshop-e 3-ditore me tema që lidhen me: deontologjinë, menaxhimin e projekteve, menaxhimin strategjik, menaxhimin e burimeve njerëzore, aftësitë e lidhshme, transformimin digjital

Këto workshop-e do të rrisin aftësitë e përgjithshme në fushat me interes për shërbimin civil. Për sa i përket trajnimeve të organizuara, seminarët do të fokusohen në një qasje të bazuar në praktikë dhe shumë ndërvepruese.

Vizitë studimore një javore në Francë dhe Gjermani për temat e reformës në administratë dhe çështjet evropiane

Kjo vizitë studimore do të kombinojë prezantimet dhe takimet në Francë dhe Gjermani.

Në Francë, takimet do të zhvillohen në administratën publike përgjegjëse për menaxhimin e shërbimit civil, politikat publike, reformat e administratës publike dhe çështjet evropiane. Ky aktivitet synon t'u japë pjesëmarrësve mundësinë për t'u takuar dhe lidhur me nëpunësit civilë aktualë të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave në shtetet anëtare të BE-së. Takimet do të nxisin shkëmbimin e përvojave dhe rrjetëzimin. Një raport në grup me mësimet kryesore të nxjerra nga vizita studimore, pritet të hartohet nga pjesëmarrësit.

Një vizitë studimore një javore në Itali mbi qeverisjen në shumë nivele dhe menaxhimin e ndihmës strukturore evropiane

Vizita studimore në Itali do t'i lejojë pjesëmarrësit të kuptojnë dhe vëzhgojnë strukturën e administratës publike italiane dhe kuadrin e saj në shumë nivele. Pjesëmarrësit do të takohen me nëpunësit civilë përgjegjës për zyrat publike në nivel rajonal dhe komunal dhe me rrjetin e palëve të interesuara të zyrave të tilla. Gjithashtu, vizita do të parashikojë takime, tryeza të rumbullakëta dhe kontakte të drejtpërdrejta me nëpunës civilë italianë që menaxhojnë fondet strukturore evropiane.

10 javë praktikë punë në Francë, Gjermani, Itali, Kroaci dhe Greqi

Një aset i rëndësishëm për pjesëmarrësit do të jetë mundësia për të kryer praktika pune të organizuara nga anëtarët e konsorciumit në administratat publike të 5 shteteve të ndryshme anëtare të BE-së. Praktika do të organizohet në anglisht por do të ofrohet edhe në gjuhën frënge, gjermane, italiane, greke dhe kroate. Anëtarët e konsorciumit do t'u ofrojnë pjesëmarrësve një akses të gjerë në administratat publike dhe sistemet institucionale në një mënyrë të balancuar gjeografikisht brenda Bashkimit Evropian.

Praktikat e punës do të organizohen me qëllimin kryesor për të mbështetur zhvillimin e aftësive të nëpunësve civilë shqiptarë që marrin pjesë në program. Objektivat e mëtejshme do të jenë pajisja e pjesëmarrësve me mjetet, metodat dhe praktikat më të mira të transferueshme në administratën e vendit të tyre. Zhvillimi i një rrjeti të qëndrueshëm kontaktesh brenda administratës së shtetit anëtar pritet të theksohet në perspektivën e hapave të ardhshme drejt anëtarësisë të Shqipërisë në BE.

Praktikat do të përforcojnë aftësitë e pjesëmarrësve duke i lejuar ata të zbulojnë dhe vëzhgojnë mënyrën në të cilën kryhet zbatimi i politikave ose ofrimi i shërbimeve në administratën pritëse. Për më tepër, të gjithë pjesëmarrësit do të inkurajohen të marrin pjesë aktive në aktivitetet e administratës pritëse dhe të

bëhen pjese e ekipit pritës. Qasja e të mësuarit praktik do të inkurajohet fort për të siguruar përvetësimin afatgjatë të kompetencave të reja.

Për të siguruar një lidhje të konsoliduar me prioritetet e përcaktuara nga qeveria e Shqipërisë për këtë projekt, pjesëmarrësit do të marrin mbështetje për të përcaktuar dhe fokusuar trajnimin dhe praktikën e tyre në projekte specifike individuale (ose në grupe) të lidhura me prioritetet e politikave që lidhen me fushën e tyre të punës. Në këtë drejtim, projekti do t'u mundësojë atyre të zhvillojnë kompetencat e tyre në një qasje të bazuar në projekt. Pjesëmarrësit do të udhëhiqen në ndërtimin e mjeteve të sakta dhe praktikave më të mira për përforsimin e politikëbërjes dhe zbatimit në fushën e tyre profesionale. Kjo punë do të kryhet përmes pjesëmarrjes aktive në trajnime dhe praktika dhe do të rezultojë në hartimin e një raporti individual. Ky raport do të prezantohet në fund të programit dhe do të vlerësohet nga një panel me përfaqësues të administratës publike në Shqipëri.

Një mentor për praktikën e punës do të caktohet për çdo praktikant dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe ndjekjen e praktikantit gjatë gjithë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së tyre brenda administratës pritëse. Mentori do të lehtësojë integrimin e praktikantit brenda institucionit dhe ekipit. Mentori do të drejtojë punën e përditshme të të trajnuarve dhe do të raportojë përparimin dhe çdo sfidë tek zyrtarët e projektit të vendit të konsorciumit. Mentorët do të identifikohen bazuar në përvojën e tyre dhe sfondin menaxherial brenda administratës pritëse.